



Vechro Pro

Llaç silikoni

Llaç akrilik prej silikoni



Norma e shpërndarjes: 2.2
Kg/m²



Tharja: 4 - 6 orë



Hollimi: Me ujë deri në 2%



Rilyerja e shtresës: 1 shtresë



Paketimi: 25 kg

Aplikimi: Spatulë

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Llaç i përforcuar me fibra akrilike prej silikoni, në formë paste, me bazë organike dhe veti hidrofobike, i gatshëm për përdorim në fasada dhe mure në ambiente të brendshme të ndërtesave. Përdoret si suva me një shtresë mbi nënshtresa prej betoni, në llaç konvencional, pllaka çimentoje, pllaka gipsi, sipërfaqe të lyera më parë etj. Përdoret gjithashtu si shtresë e fundit finiturë në sistemet e izolimit të jashtëm termik. Ka ngjitje e shkëlqyer dhe elasticitet të lartë. Ka veti hidrofobike, është rezistente ndaj ujit dhe lejon frymëmarrjen e avujve të ujit. Është certifikuar me markën CE, në përputhje me standardin EN 15824.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Tekstura	E sheshtë 1.5 mm
Pesha e veçantë	1.75 - 1.85 kg/litër.
Norma e shpërndarjes	E sheshtë 1.5 mm: përafërsisht 2.2 kg/m ² Konsum mesatar. Mund të ketë devijime të vogla, në varësi të trashësisë së shtresës dhe ashpërsisë së sipërfaqes ku do të përdoret.
Hollimi	Me përmbajtje uji deri në 2%.
Tharja	Thahet për t'u prekur në 4 - 6 orë. Kjo kohë mund të jetë më e gjatë në kushte të motit të ftohtë ose të lagësht.
Rilyerja e shtresës	1 shtresë
Klasi VOC	a. "Mure të ambienteve të jashtë prej nënshtrese mineralesh". Tipi WB. Kufiri për VOC =40 gr/litër. Maksimumi i përbërësit VOC të produktit gati për përdorim = 39 gr/litër.
Nuancat	Produkti disponohet në ngjyrë të bardhë, e cila përdoret edhe si bazë e bardhë dhe së bashku me bazën transparente ngjyrosjet përmes sistemit të ngjyrosjes së Vechro-Color Moods.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Nënshtresa duhet të jetë e pa plasarit, e lëmuar, e pastër, pa pluhur dhe yndyrë, e fortë dhe e thatë. Pastroni me kujdes sipërfaqet nga pluhuri, nga vajrat, bojërat e vjetra, pjesët që lëvizin, mbetjet e mykut etj.

Aplikoni produktin PRO PLASTER PRIMER në sipërfaqen e dëshiruar dhe pas një kohe prej të paktën 3 - 4 orësh aplikoni produktin PRO PLASTER SILICONE. Kjo kohë mund të jetë më e gjatë në kushte të motit të ftohtë ose të lagësht.

APLIKIMI

Përzieni mirë përpara përdorimit. Aplikoni një shtresë të produktit PRO SILICONE PLASTER me një spatulë inoksi në një trashësi proporcionale me kokrrizën maksimale të zgjedhur. Për të krijuar relievin përfundimtar, fërkoni me spatulë plastike teksa shtresa e materialit është ende e njomë. Koha e saktë e lëmimit varet nga vetitë përthithëse të nënshtresës dhe temperatura e ambientit.

Përdorni metodën e aplikimit "wet to wet" ("e lagësht mbi të lagësht"), për të shmangur fenomenin e përbërjeve të dukshme.

PASTRIMI I MJETEVE TË PUNËS

Pastroni mjetet e punës menjëherë pas aplikimit me ujë të ngrohtë dhe sapun. Mos i zbrazni lëngjet e larjes në tavolinën e ujit.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura e ambientit dhe e nënshtresës nuk duhet të jetë më e ulët se +5°C dhe më e lartë se +35°C, ndërsa lagështia relative nuk duhet të jetë mbi 80%. Kushtet e pafavorshme gjatë aplikimit mund të kenë pasoja negative, duke shkaktuar ndryshim në vetitë përfundimtare të materialit.

Shtresa e freskët duhet të mbrohet nga avullimi i papritur i ujit (rrezet e drejtpërdrejta të diellit, ajri, temperaturat e larta), i ftohti dhe shiu, derisa të thahet plotësisht. Pas ngurtësimit të materialit nuk nevojitet mbrojtje nga dukuritë e motit.

Sipërfaqet e reja duhet të thahen dhe të pastrohen 3 - 4 javë përpara përgatitjes së nevojshme.

RUAJTJA E PRODUKTIT

Pas përdorimit, mbylleni enën fort për ta ruajtur atë në gjendje të mirë për përdorim në të ardhmen. Të ruhet në ambiente të mbyllura me temperaturë nga +5°C deri në +35°C. Mbroni materialin nga ngrica dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj rrezeve diellore.

SIGURIA

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Për masat paraprake-udhëzime të detajuara, këshillohuni me skedën e të dhënave të sigurisë të produktit.

Të dhënat teknike dhe udhëzimet e përfshira në këtë fletëpalosje teknike bazohen në auditimet e laboratorëve dhe janë rezultati i njohurive dhe eksperiencës së personelit shkencor të kompanisë. Cilësia e produktit garantohej nga kompania, e cila është në përputhje me kërkesat e standardeve ISO 9001, 14001 dhe EMAS. Ne, si prodhues i produktit, ne nuk jemi përgjegjës për asnjë dëmtrim të shkaktuar nëse produkti nuk është përdorur saktë gjatë aplikimit dhe në përputhje me udhëzimet përkatëse për përdorimin.

